



## REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

Rev.nr.323/2020

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Albert Zogaj, kryetar i kolegjit, Erdogan Haxhibeqiri dhe Gyltene Sylejmani, anëtar të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit K. G. nga ..., Rr. “...” nr..., kundër të paditurit M. S. nga Prizreni Rr.“...”, nr..., të cilin e përfaqëson i autorizuari Y. K., avokat në ...dhe me autorizim bartës E .R., avokat nga ..., për shkak të anulimit të ujdisë gjyqësore, duke vendosur sipas revizionit të paraqitur nga paditësi kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.nr.4900/2018, të datë 18.12.2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 26.11.2020, mori këtë:

### A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pa bazuar revizioni i paditësit K. G., nga ..., Rr. “...” nr..., i paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4900/2018, i datës 18.12.2019.

### A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.4900/2018, të datës 18.12.2019, është refuzuar si e pa bazuar ankesa e të autorizuarit të paditësit K. G. nga ...Rr. “...” nr..., ndërsa është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prizren, C.nr.402/2014, i datës 21.05.2018, me të cilin në pikën I (një) të dispozitivit është refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit K. G., nga Prizreni, me të cilën ka kërkuar të miratohet kërkesëpadia, ashtu që të shpallet në tersi nule ujdia gjyqësore e lidhur në Gjykatën

Komunale në Prizren, në lëndën C.nr.117/04, të datës 24.03.2014, si dhe të detyrohet i padituri të liroj hapësirën në sipërfaqe diku 3m<sup>2</sup>, pjesë e parcelës kadastrale nr..., Z.K. Prizren, përfshirë edhe detyrimin për pagesën e shpenzimeve të procedurës në shumën prej 700.00 Euro.

Kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit, në afat ligjor ka paraqit revizion paditësi për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 181 paragraf 1, pika a), lidhur me nenin 182 paragraf 2, pika n), të Ligjit të Procedurës Kontestimore (LPK) dhe për shkak të zbatimit të gabuar të drejtës materiale nga neni 181 paragraf 1, pika c), e lidhur me nenin 184 të LPK-së, me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës, t'a pranoj revizionin si të bazuar dhe t'a ndryshoj aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.4900/2018, të datës 18.12.2019, dhe aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Prizren C.nr.402/2014, të datës 21.05.2018, ashtu që të aprovoj kërkesëpadinë e paditësit K. G., si të bazuar ose të njëjtat t'i anuloj dhe lëndën ta kthejë në rigjykim në shkallë të parë.

Përgjigje në revizion nuk ka paraqit pala e paditur.

Gjykata Supreme e Kosovës, në procedurën e vendosjes sipas revizionit në kuptim të dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) nga neni 211, 212 dhe 215 gjeti se:

Revizioni i paditësit është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi K. G., përmes të autorizuarit të tij me datë 06.05.2014, në gjykatën e shkallës së parë ka paraqitur padi kundër të paditurit M. S., me të cilën ka kërkuar që të shpallët në tërësi nule ujdia gjyqësore e lidhur në Gjykatën Komunale në Prizren, C.nr.117/04, e datës 24.03.2014, si dhe të detyrohet i padituri që ta liroj hapësirën diku 3m<sup>2</sup>, pjesë e ngastrës kadastrale ..., ZK Prizren, përfshirë edhe pagesën e shpenzimeve të procedurës.

Gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar me arsyetim se në procedurën e të provuarit gjykata në cilësinë e provës materiale e ka administruar ujdinë gjyqësore të datës 24.03.2004, me shenjën C.nr.117/04, nga e cila ka konstatuar se

paditësi M. S., ka paraqitur ofertë për pajtim gjyqësor me të paditurin K. G., e cila ofertë është pranuar nga i padituri, ndërsa gjykata e ka miratuar pajtimin gjyqësor. Sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së parë në kohën e lidhjes së pajtimit gjyqësor sipas Ligjit të Procedurës Kontestimore, (gazeta zyrtare e RSFJ, nr.4/76) nuk kanë ekzistuar dispozita për afatshmërinë e padisë lidhur me kërkesën për anulimin e ujdisë gjyqësore, andaj ujdia gjyqësore është kontratë e palëve dhe për çdo mosmarrëveshje pas lidhjes së saj, palët mund ta godasin me padi. Sipas dispozitës së nenit 374 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve ( Gazeta Zyrtare e RSFJ, nr.3/3/1978), kërkesat reciproke nga kontratat në qarkullimin e mallrave dhe shërbimeve, parashkruhen në afat prej 3 vjetësh. Në këtë rast jo vetëm që ka kaluar afati, por ka kaluar edhe afati i përgjithshëm prej 10 vitesh.

Gjykata e Apelit me aktvendimin Ac.nr.4900/2018, të datës 18.12.2019, e ka refuzuar si të pa themeltë ankesën e të autorizuarit të paditësit, ndërsa aktgjykimin e shkallës së parë e ka vërtetuar.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën e shqyrtimit dhe vendosjes sipas ankesës ka gjetur se gjykata e shkallës së parë, duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, ka zbatuar drejt dispozitat e procedurës kontestimore dhe të drejtën materiale kur ka gjetur se kërkesëpadija e paditësit është e pabazuar. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë, sipas vlerësimit të gjykatës së shkallës së dytë është i drejtë dhe i ligjshëm edhe sa i përket të drejtës materiale sepse në kohën e lidhjes së pajtimit gjyqësor ka qenë në fuqi ligji i vjetër i Procedurës Kontestimore, i cili nuk ka pas dispozita për afatshmërinë e padisë, ndërsa pajtimi gjyqësor është konsideruar kontratë për të cilën vlejnë dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata e Apelit e ka pranuar qëndrimin e gjykatës së shkallës së parë për parashkrimin e kërkesës në pajtim me dispozitat e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga një gjendje e tillë e çështjes e pranon si të drejtë dhe të ligjshëm qëndrimin e gjykatës së shkallës së dytë dhe të gjykatës së shkallës së parë, pasi që aktgjykimet e instancave me të ulëta nuk janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore dhe as në zbatim të gabuar të së drejtës materiale.

Pretendimet e paraqitura në revizion se aktgjykimet e instancave më të ulëta janë të përfshira në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) e LPK-së, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës nuk janë të themelta. Kjo për shkak se gjykatat e instancave më të ulëta i janë përmbajtur në tërësi kërkesave të LPK-së, për strukturën dhe përmbajtjen e aktgjykimit. Në aktgjykimin e shkallës së parë dispozitivi është i rregullt e në përputhje të plotë me arsyetimin e dhënë, ndërsa aktgjykimi i shkallës së dytë përmban arsye të mjaftueshëm dhe bindëse për të gjitha pretendimet e paraqitura në ankesë, përfshirë edhe shkeljet që shikohen sipas detyrës zyrtare. Në këtë kuptim aktgjykimet, ligjshmëria e të cilave kontestohet përmes revizionit janë mjaft të qarta, të rregullta në strukturë dhe përmbajtje.

Në arsyetim të aktgjykimit gjykata e shkallës së parë ka dhënë shpjegime për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë vlerësuar me peshë që gjykata të vendosë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme. Në këtë kontekst gjykata ka dhënë arsye të mjaftueshme për mënyrën e vërtetimit të fakteve, për mënyrën e vlerësimit të provave dhe për mënyrën se si faktet e çështjes janë kualifikuar në raport me normat materiale juridike nga ka rezultuar pathemelësia e kërkesëpadsisë për shkak të parashkrimit. Aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë ka përmbajtje koherente në rrjedhë logjike dhe juridike duke i arsyetuar të gjitha pretendimet ankimore dhe shkeljet që vlerësohen sipas detyrës zyrtare, lidhur me vlerësimin se aktgjykimi i shkallës së parë është i ligjshëm.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme përcaktuese për pathemelësinë e kërkesëpadsisë është fakti se palët ndërgjyqësore çështjen e tyre kontestuese e kanë përfunduar më ujdj gjyqësore të datës 02.05.2002, nr.71/2002, sipas të cilës palët me vullnet e tyre të lirë e të shprehur me veprime disponibile e kanë përfunduar procedurën kontestimore.

Gjykata Supreme e Kosovës, e pranon qëndrimin e gjykatave të instancave më të ulëta se për të vlerësuar nëse ekzistojnë shkaqe për anulimin e ujdjës gjyqësore duhet të zbatohen në mënyrë analoge dispozita e Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve, që i referohen nulitetit dhe rrëzueshmërisë së kontratave. Në këtë kontekst është pranuar edhe vlerësimi se përshtatshmërishtë zbatohen edhe dispozitat për parashkrimin e kërkesës, meqenëse Ligji për Procedurën Kontestimore, në fuqi në kohën e lidhjes së ujdjës gjyqësore nuk përcaktonte ndonjë afat për parashtrimin e padsisë. Në këtë rast nuk është marrë për bazë përmbajtja e ujdjës dhe përshtatshmëria e saj sa i përket përmbartimit, por është vlerësuar

se çështja kontestuese e cila ka ekzistuar para se të lidhet ujdia në mes të palëve ndërgjyqësore, a është konsumuar me ujdë gjyqësore, pasi që kjo paraqet formë të përfundimit të kontestit me veprime disponibile. Ujdia mund të kundërshtohet vetëm me padi për shkaqet të cilat ndikojnë në nulitetin dhe rrëzueshmërinë e kontratave, por afati i parashkrimit nuk varet nga objekti i ujdisë, por nga afati ligjor i parashkrimit të kërkesës për nulitetin apo rrëzueshmërinë e kontratës.

Rrethanat për të cilat pretendon paditësi se ndikojnë në nulitetin e ujdisë kualifikohen në grupin e shkaqeve që ndikojnë në rrëzueshmërinë e kontratës sepse në këtë rast paditësi ka pretenduar se nuk ka ekzistuar vullneti për përmbajtjen e përshkruar në ujdë duke qenë se i njëjti e ka nënshkruar në lajthim juridik ujdinë. Me dispozitën e nenit 111 të LMD parashihet së: *“Kontrata është e rrëzueshme kur e ka lidh pala me zotësi të kufizuar për të vepruar, kur gjatë lidhjes së saj ka pasur të meta në pikëpamje të vullnetit të palëve, si dhe kur kjo gjë është caktuar me këtë ligj ose me dispozita të veçanta”*. Nga dispozita e cituar rezulton se shkaqet që kanë ndikim në cenimin e vullnetit kualifikohen si rrethana që tërheqin rrëzueshmërinë e kontratës, por rrëzueshmëria mund të kërkohet vetëm brenda kohës së caktuar. Kjo për shkak se me dispozitën e nenit 117 al 1, të LMD-së, përcaktohet së: *“E drejta për të kërkuar anulimin e rrëzueshmërisë së kontratës pushon me skadimin e afatit prej një viti nga data kur të jetë ditur shkaku i rrëzueshmërisë, respektivisht i pushimit të dhunës”*, ndërsa në al 2, të nenit të njëjtë përcaktohet që: *“Kjo e drejtë në çdo rast pushon me skadimin e afatit prej pesë vjetësh nga dita e lidhjes së kontratës”*. Nga kjo rrjedh se vlerësimi i gjykatave të instancave me të ulëta për parashkrimin e kërkesës është i drejtë, por jo me referencë në dispozitën e nenit 374 të LMD-së, por sipas dispozitave referuara me sipër nga Gjykata Supreme. Në këtë rast përfundimi meritore i çështjes është i njëjtë por Gjykata Supreme e Kosovës për dallim nga Gjykata e Apelit dhe Gjykata Themelore, përfundimin për refuzimin e kërkesëpadsisë e mbështetë në dispozitat e nenit 111 dhe 117 të LMD-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, pretendimet e paditësit për anulimin e ujdisë gjyqësore nuk mund të kualifikohen në grupin e shkaqeve që tërheqin nulitetin e kontratës dhe rrjedhimisht të ujdisë, me referencë në dispozitën e nenit 103 al 1 të LMD-së, me të cilën përcaktohet së: *“Kontrata që është në kundërshtim me parimet e përcaktuara me kushtetutë të rregullimit shoqëror, me dispozitat e detyrueshëm apo me moralin e shoqërisë vetëqeverisëse (socialiste) është nule, në qoftë se qëllimi i rregullës së*

*shkelur nuk passjell ndonjë sanksion tjetër apo në qoftë se ligji në rastin e caktuar nuk parashikon diçka tjetër*". Në kuptim të dispozitës së cituar rrjedhë se marrëveshja do të ishte nule në qoftë se lënda dhe baza e marrëveshjes do të ishte në kundërshtim me kushtet e përcaktuar në dispozitën e cituar, mirëpo nga përmbajtja e marrëveshjes sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, del se lënda dhe baza e marrëveshjes janë të lejueshme. Kjo për shkak se objekti i marrëveshjes është kërkesë e disponueshme për palët, ndërsa detyrimet nga marrëveshja nuk janë në kundërshtim me rendin juridik, prandaj, marrëveshja nuk kualifikohet si nule për të cilën kërkesa nuk parashkruhet.

Pretendimet për gjendjen faktike të paraqitur në revizion nga i autorizuari i të paditurit nuk janë vlerësuar pasi që sipas dispozitës së nenit 214 paragraf 2, të LPK-së, përcaktohet së: *“revizioni nuk mund të paraqitet për shkak të konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendjes faktike”*.

Nga arsyet e paraqitura më lartë dhe në pajtim me nenin 222 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS NË PRISHTINË**

Rev.nr.323/2020 datë 26.11.2020

Kryetar i kolegjit,  
Albert Zogaj